

Shtojca 13

Autoriteti Kontraktor Sh.a Ujesjelles Kanalizime Vlore FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

27.08.2018

Për: Operatorin ekonomik “Ste-La 2000 shpk” me nr.nipti K12518401O

Procedura e prokurimit: ‘Furnizim vendosje e dy pompava për repartin e KUZ dhe një pompë dozimi për repartin e klorit’

Nr.REF-81641-08-01-2018.

Fondi limit: 1373900 (një milion e treqind e shtatë dhjetë e tremijë e nëntë qind) leke pa TVSH

Burimi i financimit: Te ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime Vlore.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 50 dite nga data e nënshkrimit të kontratës

Zhvilluar ne: dt.17.08.2018 ora 10:00.Vendi: www.app.gov.al.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, sipas raportit përfundimtar të KVO-se, miratuar nga Titullari i AK, në tender kane marrë pjesë **2** operatore ekonomik me ofertat përkatëse si më poshtë :

- 1.“Ste-La 2000 shpk” me nr.nipti K12518401O me oferte ekonomike 1329300 (njemilion e treqind e njezet e nentemije e treqind) leke pa TVSh.
- 2.“Paera” Sh.p.k me nr.nipti L31505034R me oferte ekonomike 1220000 (njemilion e dyqind e njezet mije) leke pa tvsh

Pas mbarimit të vlerësimit të ofertave është arritur në këtë përfundim:

- 1.Eshtë skualifikuar Operatori ekonomik “Paera” Sh.p.k me nr.nipti L31505034R .

Arsyet: Operatori ekonomik nuk ka mundur dot të vërtetojë :

- 1-Operatori Ekonomik duhet të këtë përvojë të suksesshme të mëparshme.

Për këtë duhet të paraqesë dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më ulët se 50 % e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

ose

punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve

të fundit, është sa dyfishi i vlerës së kontratës (fondit limit) që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Faturat tatimore të shitjes të paraqitura nga Operatori ekonomik me objekt : gjenerator, aparat saldimi, makine korrese bari dhe matesa uji nuk e plotesojne kete pike te kapacitetit teknik pasi nuk konsiderohen pune te ngjashme dhe nuk jane paraqitur punime qe kan te bejne me te njejten natyre ne pastrime te stacioneve te KUZ dhe eksperienca ne montimin te pompave te kesaj natyre.

- 2- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot të vërtetojë piken B të kapacitetit teknik ku kerkohet : B.Licensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e objektit të

kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme sipas modelit MPPTT :

NP-7 A

NP-11A,

NS-3A,

NS-13A,

NS-14A,

NS-18A.

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument per te vertetuar kete pike te kapacitetit teknik.

3- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje piken C te kapacitetit teknik ku kerkohet :

Operatori ekonomik duhet te disponoje nje staf teknik te inxhinierëve te perbere prej

- Ing.hidroteknik 1 person
- Ing.gjeodet/topograf 1 person
- Ing.mekanik 1 person
- Ing.elektrik 1 person

te shoqeruar me kontraten e punes, CV, diploma. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument per te vertetuar kete pike te kapacitetit teknik.

4- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje piken D te kapacitetit teknik ku kerkohet :

D.Numri mesatar i punonjesve te siguruar duhet te jet jo me pak se **15** (pesëmbëdhjetë) punonjes per periudhen Janar 2018 – Qershor 2018. Vertetimi i paraqitur nga operatori ekonomik nga Sigurimet Shoqërore tregon se ka te regjistruar per kete periudhe nje numer jo me te madh se 9 personash te siguruar per kete periudhe, duke mos plotesuar dot nr.mesatar te siguruar te kerkuar per kete procedure.

5- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje piken E te kapacitetit teknik ku kerkohet :

Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka pjesë të stafit të shoqërisë një person që përmbush kriteret për të qenë koordinator për realizimin e punimeve në fushën e sigurisë dhe të shëndetit gjatë realizimit të punimeve, i cili duhet te jetë i pajisur me certifikatë/dëshmi trajnimi (specialist për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë) që tregon pjesëmarrjen e tij në kurse specifike për sigurinë, të organizuara nga subjekte të njohura publike ose private, sipas kërkesave të ligjit nr. 10237 date 18.02.2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune” dhe V.K.M. nr. 312, datë 05.05.2010 “Përmiratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Staf i trajnuar nga trupa certifikuese te njohura si me poshte:

-Specialiste per : Punime ne lartesi DPI. Renia nga lartesi (DPI.Skela,shkalle,Skarpata... etj).

a- 1 (nje) inxhinier,

b- 2 (dy) specialist

-1 (nje) Specialist per Sigurimin teknik dhe mbrojtjen e shendetit ne pune

-1 (nje) Specialist (Sigurimi Teknik i punonjesve dhe masat mbrojtese ne pune

-1 (nje) Specialist per Ndihma e pare dhe nderhyrja ndaj emergjencave

-1 (nje) manovrator me deshmi manovratori, per perdorimin dhe manovrimin e mjeteve te rend ate punes ne ndertim (DPI . Eskavatore,Fadroma,Rula etj)

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument per te vertetuar kete pike te kapacitetit teknik.

6- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje piken F te kapacitetit teknik ku kerkohet :

Shoqeria duhet te kete ne liste pagesat e shoqerise mjekun, shoqeruar me kontrate pune noteriale cv, diplome. **Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument per te vertetuar kete pike te kapacitetit teknik.**

7- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje piken H te kapacitetit teknik ku kerkohet :

Operatori Ekonomik duhet te paraqese Certificate Konformiteti ISO 9001: 2015, ISO 14001- 2015, ISO 39001:2012, Certificate ISO , PAS 99-2012, Certificate OHACAC 18001:2007, ISO 8000-2014; ISO 50001-2011 (Ne rastet e bashkimit te operatoreve ekonomike, cdo anetari grupit duhet te paraqese certifikaten ISO). Ne certifikatat ISO te paraqitura nga Operatori Ekonomik mungojne certifikatat e kerkuara ISO si me poshte : ISO 39001:2012, ISO 8000-2014, dhe ISO 50001-2011

8- Operatori ekonomik nuk ka mundur dot te vertetoje piken K te kapacitetit teknik ku kerkohet :

K.Deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik, qe nevojiten per ekzekutimin e kontrates

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnje dokument per te vertetuar kete pike te kapacitetit teknik.

Eshte kualifikuar Operatori ekonomik i poshtëshënuar :

1. Ste-La 2000 shpk me nr.nipti K12518401O me oferte ekonomike 1329300 (njemilion e treqind e njezet e nentemije e treqind) leke pa TVSh.

Arsyet: Operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi është paraqitur në tender me te gjithë dokumentacionin e kërkuar nga ana e Autoritetit Kontraktor në Dokumentat Standarte te Tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik Ste-La 2000 shpk me nr.nipti K12518401O se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme 1329300 (njemilion e treqind e njezet e nentemije e treqind) leke pa TVSh.

.../pikët totale të marra / ____/ është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoriteti Kontraktor Sh.A Ujësjeles Kanalizime Vlore **Lagja:Kushtrimi Rruga:** Arkobaleno, sigurimin e kontratës. Se bashku me sigurimin e kontratës duhet te sillni brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/ publikimit të këtij njoftimi, te gjithë dokumentacionin e paraqitur ne tender (origjinal ose fotokopje e noterizuar), i cili verifikohet nga KVO dhe behet pjese e dosjes se tenderit.

Dokumentacioni i listuar me shkrim dhe numër faqesh, duhet te jete i futur ne një zarf te mbyllur dhe i vulosur me vulën e operatorit/subjektit. Zarfi i dokumentacionit te tenderit duhet te paraqitet brenda afatit te mësipërm, ne sekretarin e Sh.A UK Vlore për tu protokolluar.

Nëse dokumentacioni i tenderit, pas verifikimit rezulton i rregullt, atëherë do te procedohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës, nga përfaqësuesit e te dy palëve.

Njoftimi i Klasifikimit është bere ne dt.17.08.2018 ne faqen zyrtare te APP-se.

Ankesa: ka ose jo. **Jo**

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor] **Dorian XHELILI Administrator.**

